



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e premte, datë 27.09.2024, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Armela	KRASNIQI	Kryetar
Desada	METAJ	Zëvendëskryetar
Aurela	BICJA	Anëtar
Besian	ZOGAJ	Anëtar
Gjergji	HAMITI	Anëtar
Jetmir	HALILAJ	Anëtar
Joana	ALLUSHI	Anëtar

AMA, pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës vendosi:

1. Miratimin e ndryshimeve të ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë “Novanet” sh.p.k, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve, mbështetur në rrjet kabllor “TV Kabllor Novanet”. (**Vendim nr. 98, datë 27.09.2024**)
2. Miratimin e ndryshimeve të ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë “Radio ON” sh.p.k, licencuar për subjektin audio analog privat rajonal “Play Radio”. (**Vendim nr. 27, datë 27.09.2024**)
3. Miratimin e ndryshimeve të ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë “MRM” sh.p.k, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve, mbështetur në rrjet kabllor “TV Kabllor Korça”. (**Vendim nr. 100, datë 27.09.2024**)
4. Rinovimin e licencës së shoqërisë “Radio Sol” sh.p.k., licencuar për subjektin audio privat rajonal “Radio Sol”. (**Vendim nr. 101, datë 27.09.2024**)

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 27 shtator 2024